


MARRËVESHJET E TREGTISË
SË LIRË DHE INTEGRIMI
TREGTAR MIDIS VENDEVE TË
EVROPËS JUGLINDORE:
VLERËSIME TË MODELIT
TË GRAVITETIT

Alban Pllaha*

05 (55) 2012

ALBA TËRRIA DËSKUTIM

BANKA E SHQIPËRISË



*Alban Pllaha, Departamenti i Kërkimeve, Banka e Shqipërisë,
e-mail: apllaha@bankofalbania.org

Pikëpamjet e shprehura në këtë material janë të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Bankës së Shqipërisë.

Dëshiroj të falënderoj drejtorin e Departamentit të Kërkimeve në Bankën e Shqipërisë, Ph.D. Altin Tanku, për të gjithë ndihmesën, mbështetjen dhe këshillat e dhëna. Falënderoj gjithashtu z. Ilir Vika për komentet dhe vlerësimet e tij të vlefshme në "Takimin e 5-të Rajonal të Kërkimeve Ekonomike në Evropën Juglindore". U jam gjithashtu mirënjohës të gjithë kolegëve të tjerë të Departamentit të Kërkimeve në Bankën e Shqipërisë për krijimin e një mjedisi të shkëlqyer dhe mbështetës për hulumtim shkencor.

PËRMBAJTJA

<i>Abstrakt</i>	5
<i>1. Hyrje</i>	6
<i>2. Karakteristikat e tregtisë së vendeve të EJK-9</i>	9
<i>3. Modelimi empirik për integrimin e tregtisë</i>	12
<i>4. Rezultatet empirike</i>	20
<i>5. Përfundime</i>	27
<i>Literaturë</i>	28
<i>Shtojca</i>	31

ABSTRAKT

Ky material bën një vlerësim të flukseve tregtare ndërmjet vendeve të Evropës Juglindore (EJL-9), duke përfshirë dinamikat në një model graviteti të të dhënave në panel. Përqasja e GMM-së rezulton të jetë modeli i duhur ekonometrik që lejon përfshirjen e dinamikave në modelet e gravitetit për tregtinë. Modeli prodhoi rezultate të qarta (në drejtim të diagnostikimit statistikor), duke nënvizuar se tregtia aktuale ndikohet nga flukset tregtare të kaluara (paraardhëse). Në përputhje me literaturën mbi modelet e gravitetit për tregtinë, materiali del në përfundimin se tregtia ndikohet pozitivisht nga PBB-ja, MTL-të, lidhjet koloniale dhe fqinjësia. Ndërkohë, flukset tregtare rezultojnë të ndikuara negativisht nga distanca fizike e transportit ndërmjet dy vendeve. Një rezultat tjetër i këtij materiali është se MTL-të kanë kontribuar pozitivisht në integrimin e tregtisë rajonale. Megjithatë, gjetjet sugjerojnë se pjesa më e madhe e EJL-9 tregtojnë nën potencialin e tyre.

Klasifikimi JEL: C13, C23, F10

Fjalë kyçe: Dinamika, model graviteti, integrim tregtar, integrim rajonal, EJL-9, potencial tregtar, model GMM, Marrëveshje të Tregtisë së Lirë (MTL), flukse tregtare.

1. HYRJE

Gjatë viteve '90, rajoni i Ballkanit karakterizohej nga një paqëndrueshmëri politike dhe ekonomike, konflikte të armatosura dhe etnike, skema piramidale, qeveri të përkohshme, ndarje të federatave (ndarja e ish-Jugosllavisë), formime të shteteve të reja etj. Këto karakteristika kanë pasur ndikime të konsiderueshme mbi secilin vend ballkanik. Në ditët e sotme, vendet e Evropës Juglindore (EJL) ndodhen në etapa të ndryshme të zhvillimit dhe integritit me BE-në. Pothuajse të gjitha këto vende kanë një aspiratë të qartë për integrimin në BE, madje disa prej tyre janë tashmë pjesë e BE-së (Bullgaria, Rumania dhe Sllovenia). "Procesi i Stabilizim-Asociimit (PSA) është politika e BE-së drejt vendeve të Ballkanit Perëndimor, e krijuar me qëllim integrimin evropian. Vendet e EJL-së (veçanërisht vendet e Ballkanit Perëndimor) janë të përfshira në një partneritet progresiv, për stabilizimin e rajonit dhe krijimin eventual të një zone të tregtisë së lirë" (Pakti i Stabilitetit për EJL-në, 2005). Qëllimi ekonomik i PSA-së është vendosja e objektivave të përbashkët ekonomikë. Me fjalë të tjera, ky proces synon krijimin e një zone rajonale të tregtisë së lirë, e cila është gjithashtu e mirintegruar financiarisht, politikisht dhe institucionalisht.

Siç shpjegohet dhe më lart, krijimi i një zone të tregtisë së lirë ndërmjet vendeve të EJL-së është pjesë e PSA-së. Për rrjedhojë, pothuajse të gjitha vendet e Ballkanit kanë nënshkruar Marrëveshje dypalëshe të Tregtisë së Lirë (MTL) ndërmjet tyre¹. Pjesa më e madhe e këtyre marrëveshjeve u nënshkrua në fillim të viteve 2000. Por deri në çfarë mase e kanë arritur objektivin e tyre këto MTL

¹ Kosova ka pasur një marrëveshje të përkohshme me Maqedoninë, e cila pasoi nga marrëveshja me Serbinë dhe Malin e Zi (këto marrëveshje nuk janë MTL të plota, duke qenë se disa produkte specifike janë subjekt i taksave kufitare në përputhje me marrëveshjet specifike). Ndërkohë, Kosova ka nënshkruar MTL me këto vende rajonale: Republikën e Shqipërisë (që nga data 01.10.2003); Republikën e Maqedonisë (që nga data 03.08.2005); Republikën e Kroacisë (që nga data 01.11.2006); dhe me Republikën e Bosnje-Hercegovinës (që nga data 12.12.2006).

Vlen të përmendet se MTL-të me Shqipërinë dhe Bosnje-Hercegovinën janë tërësisht të lira për të gjitha produktet nga ato bujqësore (kapitulli 1-24) e deri tek ato industriale (kapitulli 25-97). Ndërkohë, MTL-të me Maqedoninë dhe Kroacinë kanë disa kufizime mbi disa produkte të importuara nga këto dy vende. Përsa u përket produkteve me origjinë kosovare, nuk ka asnjë kufizim gjatë eksportit drejt këtyre dy vendeve, që do të thotë se mallrat janë të përjashtuara nga detyrimet doganore". Për më shumë informacion, shiko: <http://www.ceftatradeportal.com>

dypalëshe? A është rritur tregtia dypalëshe që nga ky moment? A janë vendet e Ballkanit të integruara ekonomikisht (në terma tregtarë)? A ekziston mundësia për intensifikim të mëtejshëm të tregtisë ndërmjet vendeve të EJT-së?

Ky material diskutimi synon të bëjë një vlerësim të gjendjes së flukseve tregtare ndërmjet vendeve të EJT-së, si dhe të vlerësojë nëse MTL-të e nënshkuara kanë ndikuar ose jo flukset tregtare ndërmjet vendeve të EJT-së. Për të arritur këtë qëllim, materiali përdor përqasjen e modelit të gravitetit, i cili në ditët e sotme është një nga modelet empirike më të përdorura në vlerësimin e tregtisë ndërkombëtare.

Studiues të fushës së integritimit ekonomik sugjerojnë se ekzistojnë mjaft argumente ekonomike që theksojnë se tregtia aktuale mund të ndikohet nga tregtia në të kaluarën. Për shembull, disa autorë argumentojnë se tregtia në të kaluarën ndikon mbi tregtinë aktuale përmes konceptit të “forcës së zakonit”. Me fjalë të tjera, nëse konsumatorët kanë përdorur gjatë viteve të fundit një produkt specifik, ata janë mësuar me këtë produkt. Kjo “forcë e zakonit” kontribuon në tregtinë aktuale dhe në atë në të ardhmen (Eichengreen dhe Irwin 1997; Bun dhe Klaassen 2002). Argumentet e mësipërme sugjerojnë se flukset tregtare në të kaluarën ndikojnë në flukset tregtare aktuale dhe në ato të ardhshme. Megjithatë, pjesa më e madhe e studimeve në të kaluarën përdorin përqasjen e modelit të gravitetit statik OLS, e cila nuk konsideron rëndësinë e një dinamike të tillë në shpjegimin e flukseve tregtare.

Literatura mbi integrimin tregtar të rajonit të Ballkanit është disi e kufizuar dhe e pamjaftueshme. Nga ana tjetër, dinamikat në modelet e gravitetit mbeten ende një fushë e pastudiuar mjaftueshëm në ekonometri. Kështu, ky material diskutimi synon të kontribuojë si në literaturën mbi integrimin tregtar të rajonit të EJT-së, ashtu dhe në literaturën ekonometrike mbi rëndësinë e dinamikave në modelet e gravitetit për tregtinë.

Flukset tregtare ndërmjet 9 vendeve të EJT-së (EJT-9) do të jenë fokusi kryesor i këtij materiali. Vendet specifike që do të vlerësohen në material janë: Bosnje-Hercegovina, Bullgaria, Kroacia,

Maqedonia, Rumania, Serbia dhe Mali i Zi², Sllovenia, Shqipëria dhe Turqia. Ndonëse Kosova³ është një partner i rëndësishëm tregtar për disa prej vendeve të EJL-9, ajo nuk përfshihet në vlerësimet e gravitetit për shkak të të dhënave të pamjaftueshme. Ky material përdor një grup të dhënash në panel prej $N = 792$ flukse tregtare dypalëshe vjetore (vëzhgime), të marra nga Baza e të Dhënave Statistikore mbi Tregtinë e Grupmallrave të Kombeve të Bashkuara (UN comtrade), ndërmjet vendeve të EJL-9 gjatë një periudhe $T = 11$ vjet (nga viti 2000 deri në vitin 2010).

Si model bazë, materiali përdor modelin e gravitetit të Frankel, Stein dhe Wei (1997), për të ndërtuar më pas një model të ri ekonometrik tërësisht të specifikuar, i cili lejon përfshirjen e dinamikave në shpjegimin e flukseve tregtare. Për të mundur përfshirjen e dinamikave në vlerësimin e modelit të gravitetit, materiali përdor përjasjen e vlerësimit GMM.

Struktura e këtij materiali diskutimi është si vijon: Seksioni i dytë analizon karakteristikat e flukseve tregtare të vendeve të EJL-9. Seksioni i tretë ofron një pasqyrë të literaturës mbi modelet e gravitetit, të dhënat në panel, dinamikat dhe vlerësimin GMM. Ky seksion gjithashtu argumenton mbi arsyetimin ekonometrik dhe teorik në ndërtimin e modelit dinamik. Seksioni i katërt bën një përshkrim të të dhënave, diskuton mbi rezultatet e modelit dhe trajton zbatimet e mundshme. Seksioni i pestë paraqet përfundimet.

² Ndonëse Serbia dhe Mali i Zi janë dy vende të pavarura që nga muaji qershor i vitit 2006, në këtë material ato konsiderohen si një vend i vetëm (për arsye të administrimit të të dhënave) e për rrjedhojë, flukset e tyre tregtare shumëhen.


³ Kosova e shpalli pavarësinë në muajin shkurt të vitit 2008. Të dhënat mbi flukset tregtare të Kosovës janë të pamjaftueshme.

2. KARAKTERISTIKAT E TREGTISË SË VENDEVE TË EJL-9

Analizimi i tipareve dhe karakteristikave tregtare të vendeve të Evropës Juglindore do të ndihmonte në krijimin e një imazhi më të qartë përse i përket tregtisë rajonale. Paraqitjet grafike në Grafikon 1 tregojnë disa karakteristika të tregtisë individuale (bilanci tregtar, eksportet, importet dhe investimet e huaja) të vendeve të EJL-9. Gjatë analizimit të grafikëve përbërës të Grafikut 1, vihet re se tipari më i dukshëm dhe i përbashkët tregtar i vendeve të EJL-9 është orientimi i tyre drejt importeve. Duke përfshirë Slloveninë, pothuajse të gjitha vendet e tjera janë të karakterizuara nga një bilanc tregtar negativ. Duket se konsumi i brendshëm në vendet e rajonit nuk mund të plotësohet nga prodhimi vendas, duke çuar kështu në ekonomi të orientuara drejt importeve.


Megjithatë, vëllimet tregtare janë rritur vazhdimisht në vendet e EJL-9, veçanërisht pas vitit 2002. Për shembull, Grafiku 2 tregon se vëllimet tregtare të këtyre vendeve nga viti 2002 deri në vitin 2008 janë më shumë se trefishuar (vija e zezë në Grafikon 2). Krahas kësaj, vëllimet tregtare ndërmjet vendeve të EJL-9 janë rritur nga 6,720 milionë dollarë në vitin 2002 në 28,913 milionë dollarë në vitin 2010 (vlerat korresponduese të vijës blu në Grafikon 2). Brenda 8 viteve, vëllimet tregtare ndërmjet vendeve të EJL-9 janë rritur me më shumë se 400%. Bumi tregtar në këto vende pas vitit 2002 përkon me MTL-të dypalëshe të nënshkruara ndërmjet vendeve të EJL-9 (pjesa më e madhe e MTL-ve midis këtyre vendeve u nënshkrua në vitet 2000-2004). Vija gri e pikëzuar në Grafikon 2 tregon flukset totale tregtare ndërmjet vendeve të EJL-9 në përqindje të vëllimit total tregtar të vendeve të EJL-9. Në vitin 2010, flukset tregtare ndërmjet vendeve të EJL-9 përfaqësonin vetëm 6.5% të vëllimit tregtar total të tyre.

Grafik 1. Karakteristikat e tregtisë së vendeve të EJL-së (në milionë dollarë).



Burimi: Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH).

Grafik 2. Totali i tregtisë në përqindje të vëllimit total tregtar të vendeve të EJT-9.



Është e qartë se tregtia ndërmjet vendeve të EJT-9 përfaqëson vetëm një përqindje të vogël të vëllimit total tregtar të tyre. Megjithatë, a munden këto vende t'i intensifikojnë vëllimet tregtare ndërmjet tyre? A ka vend për intensifikim tregtar? A kanë kontribuar MTL-të dypalëshe ndërmjet vendeve të EJT-9 në intensifikimin e tregtisë ndërmjet tyre gjatë periudhës 2002-2010? Seksioni në vijim paraqet modelin e gravitetit për tregtinë. Për t'iu përgjigjur pyetjeve të mësipërme, është ndërtuar një model dinamik tërësisht i specifikuar.

3. MODELIMI EMPIRIK PËR INTEGRIMIN E TREGTISË

3.1 MODELET E GRAVITETIT

Aplikimi i modelit të gravitetit për shqyrtimin e tregtisë ndërkombëtare është shndërruar në një praktikë të zakonshme. Ky model empirik u shfaq në fillim të viteve 1960, i iniciuar nga Linder (1961), Tinbergen (1962) dhe Linnemann (1966). Për të shprehur tregtinë dypalëshe, modeli i gravitetit për tregtinë adopton koncepte nga teoria e gravitetit në fizikë⁴. Flukset tregtare ndërmjet dy vendeve konsiderohen pozitivisht të lidhura me masën ekonomike (tërheqja nga madhësia/masa) dhe negativisht të lidhura me distancën fizike të qendrave të tyre kryesore ekonomike (të shtyra nga distanca fizike). Me kalimin e kohës, modeli bazë i gravitetit është pasuruar me disa variabla të tjerë shpjegues, si për shembull numri i popullsisë, gjuha e përbashkët, tregues të ngjashmërive kulturore, etj. Modeli i gravitetit ka gjetur gjithashtu mbështetje teorike dhe ekonomike nga autorë të shumtë (Anderson 1978; Bergstad 1985; Helpman 1987; Deardorff 1998). Reputacioni në rritje i modelit të gravitetit mund t'u atribuohet mjaft faktorëve. Ndoshta, kontribuesit më të rëndësishëm janë suksesi i tij në aplikimet empirike dhe zhvillimi i tij i vazhdueshëm gjatë viteve.

Zakonisht, modelet e gravitetit për tregtinë janë vlerësuar duke përdorur një përfaqje *cross-section* OLS. Megjithatë, për vlerësimin e modeleve të gravitetit, pjesa më e madhe e autorëve në ditët e sotme përdorin teknika të të dhënave në panel. Krahasuar me modelin *cross-section* OLS, përfaqja e të dhënave në panel ofron disa përparësi. Për shembull, të dhënat në panel lejojnë përfshirjen e vëzhgimeve shtesë të serive kohore, duke çuar kështu në gjetje/parashikime më të sakta. Krahas kësaj, përdorimi i të dhënave në panel mundëson një kontroll më të mirë të përcaktuesve vendimtarë të tregtisë ndërmjet dy vendeve (të pavrojtuar dhe të pandryshueshëm në kohë), të cilët zakonisht identifikohen nga termi i gabimit në një model *cross-section* (Bun dhe Klaassen 2002).

⁴ Kjo teori nga fizika e shpjegon forcën e gravitetit ndërmjet dy trupave si në proporcion të drejtë me masat e tyre dhe negativisht në proporcion me distancën ndërmjet këtyre trupave (Isaac Newton, 1666).

Pjesa më e madhe e autorëve të fushës së integritit të tregtisë ndërkombëtare përdorin një model të panelit statik për vlerësimin e tregtisë me modelet e gravitetit, duke mos konsideruar kështu rëndësinë e dinamikave në tregtinë dypalëshe. Në terma teorikë, ekzistojnë arsye të forta ekonomike për të supozuar se flukset aktuale të tregtisë dypalëshe ndikohen nga tregtia dypalëshe në të kaluarën (dinamikat). Për shembull, nëse një kompani vendase ka eksportuar produktet e saj drejt një vendi partner, ajo gjithashtu ka krijuar rrjetet e saj të shpërndarjes dhe të shërbimit në vendin partner. Për këtë arsye, është më e lehtë (më e lirë) për këtë kompani që të vijojë të tregtojë produktet e saj në vendin partner, sesa për një kompani që hyn rishtas në treg, për shkak të kostove të hyrjes/daljes.

Një arsye tjetër e rëndësishme pse tregtia në të kaluarën besohet që ndikon mbi tregtinë aktuale është se konsumatorët në vendin partner janë mësuar me produktet e vendit eksportues (siç u shpjegua dhe në pjesën hyrëse të këtij materiali përmes konceptit të "forcës së zakonit"). Kjo sugjeron se tregtia aktuale dypalëshe do të ndikohet nga flukset tregtare të mëparshme ndërmjet dy partnerëve tregtarë (Eichengreen dhe Irwin 1997; Bun dhe Klaassen 2002).

Krahas kësaj, fenomeni i tregtisë, si për shembull partneritetet tregtare dhe preferencat tregtare kanë çuar në Unionet e Doganave, Marrëveshjet e Tregtisë së Lirë dhe në efekte dytësore mbi flukset e ardhshme tregtare (Krugman, 1993; Baldwin, 1996; Harris etj. 2008).

Për të përmbledhur argumentet e mësipërme, mund të themi se tregtia në të kaluarën ndikon në tregtinë aktuale dhe në atë të ardhme. Neglizhimi i këtij fakti mund të çojë në rezultate jo të vërteta. Autorë të kohëve të fundit nënvizojnë gjithashtu se përfshirja e dinamikave në modelet e gravitetit për tregtinë është e rëndësishme si në aspektin ekonometrik, ashtu dhe në atë teorik (De Grauwe dhe Skudelney, 2000; Bun dhe Klaassen, 2002; Harris etj. 2008). Për këto arsye, tregtia në të kaluarën përfshihet në ekuacionin e fundit (3) si një variabël shpjegues (i shpjeguar plotësisht në Seksionin 3.3 të këtij materiali).

3.2 NDËRTIMI I NJË MODELI ME SPECIFIKIME BAZË

Modeli bazë i gravitetit shpjegon flukset tregtare ndërmjet dy vendeve i dhe j (variabli i varur) si një funksion i dy përbërësve kryesorë: masat ekonomike të të dy vendeve (variabli shpjegues) dhe distanca në kilometra ndërmjet qendrave të tyre ekonomike (variabla shpjegues). Frankel, Stein dhe Wei (1997) kanë kryer një studim gjithëpërfshirës dhe bindës për të matur efektet e marrëveshjeve tregtare dypalëshe dhe shumëpalëshe. Ky material përdor modelin e gravitetit të Frankel, Stein dhe Wei (1997) si një model bazë, për të ndërtuar më pas një model të ri ekonometrik që lejon përfshirjen e dinamikave për të shpjeguar flukset tregtare. Për të vlerësuar efektet e marrëveshjeve të ndryshme të tregtisë së lirë, Frankel, Stein dhe Wei (1997) përdorin një model statik *cross-section* OLS. Modeli i tyre mund të shkruhet si vijon:

$$\log Tregtia_{ijt} = \alpha_0 + \alpha_1 \log(PBB_{it} * PBB_{jt}) + \alpha_2 \log(PBBPF_{it} * PBBPF_{jt}) + \alpha_3 \log(Distanca_{ij}) \quad (1)$$

ku: $Tregtia_{ijt}$ përfaqëson variablin për t 'u shpjeguar, logaritmi i flukseve tregtare reale dypalëshe midis vendeve i dhe j në vitin t ($i, j = 1, \dots, N, i \neq j, t = 1, \dots, T$). Ndërkohë që variablat shpjegues janë si vijon: PBB përfaqëson Prodhimin e Brendshëm Bruto (masa ekonomike e të dy vendeve), $PBBPF$ përfaqëson Prodhimin e Brendshëm Bruto për Frymë (të ardhura), $Distanca_{ij}$ përfaqëson distancën në kilometra midis qendrave ekonomike të partnerëve tregtarë. Variabli i distancës supozohet si përafres i kostos së transportit midis dy partnerëve tregtarë. α_0 është konstante; α_1 , α_2 dhe α_3 janë koeficientët që do të vlerësohen. $Tregtia$, PBB , $PBBPF$ dhe $Distanca$ shprehen në terma logaritmi natyrorë.

Modeli i gravitetit i shpjeguar më lart është i përcaktuar për t 'u aplikuar në një model *cross-section* OLS. Me qëllim që të arrihet një vlerësim më i mirë i zhvillimeve të tregtisë, nisur nga karakteristikat e vendeve të EJL-9, ky material përdor një përjasje të të dhënave në panel. Duke përdorur këtë të fundit, efektet e variablave shpjegues të pandryshueshëm në kohë, si për shembull distanca dhe variablat cilësorë të kufijve të përbashkët mund të administrohen më mirë. Për t 'i identifikuar më mirë këto efekte, modelit të mësipërm i

shtohet një variabël cilësor shtesë (një variabël cilësor i kufirit të përbashkët). Siç u përmend dhe më lart, një nga objektivat kryesorë të këtij materiali është vlerësimi i efekteve të MTL-ve dypalëshe mbi flukset tregtare ndërmjet vendeve të EJL-9. Për rrjedhojë, modelit i shtohet një variabël tjetër cilësor MTL. Disa nga vendet në fokus të këtij materiali (Bosnje-Hercegovina, Kroacia, Serbia dhe Mali i Zi dhe Sllovenia) kanë qenë pjesë e të njëjtit territor administrativ gjatë 50 viteve të fundit (ish-Jugosllavia). Kjo karakteristikë specifikohet në model përmes variablit cilësor të lidhjes koloniale. Krahas variablit cilësor të mësipërm, studime të tjera sugjerojnë disa variabla të tjerë cilësorë, të cilët mund të ndikojnë flukset tregtare ndërmjet dy vendeve: konfliktet e armatosura (luftërat), bashkimet e monedhës, kursi i këmbimit (Vika, 2006) ose variabla cilësorë të gjuhës së përbashkët dhe raporti CIF/FOB. Megjithatë, duke marrë në konsideratë karakteristikat e vendeve të EJL-9, besohet se variablat cilësorë të mësipërm janë specifikuar saktë për këtë model specifik⁵.

Modeli që rezulton është:

$$\log Tregtia_{ij} = \alpha_0 + \alpha_1 \log(PBB_{it} * PBB_{jt}) + \alpha_2 \log(PBBPF_{it} * GDPPC_{jt}) + \alpha_3 \log(Distanca_{ij}) + \alpha_4(MTL_{ij}) + \alpha_5(Lidhje\ Koloniale_{ij}) + \alpha_6(Fqinjësia_{ij}) + u_{ij} \quad (2)$$

ku: MTL është variabli cilësor i Marrëveshjeve të Tregtisë së Lirë (MTL = 1 nëse ndërmjet vendeve *i* dhe *j* ekziston një marrëveshje e tregtisë së lirë dhe MTL = 0 nëse jo), Lidhja Koloniale përfaqëson variablin cilësor të lidhjeve koloniale (Lidhje Koloniale = 1 nëse vendet *i* dhe *j* kanë qenë pjesë e të njëjtit territor gjatë 50 viteve të fundit dhe Lidhje Koloniale = 0 nëse jo), Fqinjësia përfaqëson variablin cilësor të fqinjësisë (Fqinjësi = 1 nëse vendet *i* dhe *j* ndajnë të njëjtin kufi dhe Fqinjësi = 0 nëse jo), u_{ij} është termi i gabimit.

Siç përmendet dhe më lart, ekzistojnë argumente të forta ekonomike, të cilat sugjerojnë se flukset tregtare aktuale mund të shpjegohen përmes PBB-së dhe tregtisë në të kaluarën. Për të mundësuar një dinamikë të tillë, ky material përdor metodën e vlerësimit GMM (*Generalized Method of Moments* = Metoda e Përgjithësuar e Momenteve). Bun dhe Klaassen, (2002) dhe Harris

⁵ Deri tani, nuk ekziston asnjë bashkim i monedhës ndër vendet e EJL-9.

etj. (2008) ndjekin të njëjtën përjasje (duke përdorur GMM për të mundësuar përfshirjen e dinamikave në modelin e gravitetit për tregtinë). Seksioni në vijim specifikon modelin dinamik dhe shpjegon alternativat ekonometrike kryesore të përballura gjatë shqyrtimit të të dhënave, të cilat e orientuan autorin drejt kësaj zgjedhjeje.

3.3 PËRFSHIRJA E DINAMIKAVE NË MODELIN E GRAVITETIT

Ekzistojnë mjaft argumente ekonometrike në favor të metodës GMM kundrejt metodës statike OLS.

Problemi i zakonshëm me të cilin përballemi gjatë përfshirjes së dinamikave në modelet e vlerësimit të panelit statik OLS është anshmëria e panelit dinamik, e cila çon në keqspecifikimin e modelit, duke mos lejuar studimin e efekteve të dinamikave (Bond, 2002; Baum, 2006; Baltagi, 2008; Efendic etj. 2009). Këto modele konsiderohen të keqspecifikuara pasi ato nuk marrin parasysh të gjithë historikun e variablave shpjegues (variablat në të djathtë të ekuacionit) (Bond, 2002; Greene, 2008; Efendic etj., 2009). Të dhënat për këtë vlerësim të panelit kanë karakteristikat e mëposhtme: $N = 792$ flukse tregtare dypalëshe vjetore UNCOMTRADE ndërmjet vendeve të EJT-9 gjatë një periudhe $T = 11$ vjet (2000-2010). Literatura mbi të dhënat e panelit dinamik sugjeron se modelet GMM janë të ndërtuara në mënyrë specifike dhe janë më të qëndrueshme në rastet kur T është më e vogël se N . Modeli GMM mundëson kontrollin e anshmërisë së panelit dinamik (Arellano dhe Bond, 1991; Blundell dhe Bond, 1998; Bond, 2002; Baum, 2006; Roodman, 2007; Baltagi, 2008; Efendic etj., 2009).

Në krahasim me përjasjen statike OLS, modelet GMM zotërojnë instrumente të admirueshme për të administruar më mirë problemin e endogjenitetit. Duke përdorur një model GMM, problemi i endogjenitetit mund të shmanget përmes përdorimit të instrumenteve të gjeneruara nga brenda (Greene, 2008).

Një nga kushtet më të rëndësishme gjatë përdorimit të modelit GMM është që të gjithë variablat shpjegues (variablat në të djathtë të ekuacionit) duhet të jenë ekzogjenë nga variabli që shpjegohet (në rastin tonë tregtia aktuale). Përfshirja e tregtisë së kaluar shfaq problemin e endogjenitetit. Kështu, duke përdorur metodën GMM, ky variabël mund të kontrollohet përmes instrumenteve të brendshme të kaluara, si për shembull nivele të kaluara ose diferenca të kaluara (shiko Efendic etj., 2009). Lind pyetja nëse variabli i PBB-së e përmbush kushtin e ekzogjenitetit? PBB-ja si një variabël shpjegues mund të korrelohet me termin e gabimit. Megjithatë, pjesa më e madhe e autorëve në literaturë nuk e konsiderojnë çështjen e autokorrelacionit ndërmjet termit të gabimit dhe PBB-së midis dy vendeve me argumentimin e mëposhtëm: në flukset tregtare dypalëshe, eksportet nga vendi *i* në vendin *j* janë pjesë e PBB-së së vendit *i* dhe anasjelltas. Megjithatë, eksportet drejt atij vendi përfaqësojnë vetëm një pjesë të vogël të PBB-së dhe variabli për *t*'u shpjeguar është tregtia dypalëshe dhe jo eksportet e një vendi specifik. Kështu, variabli i PBB-së konsiderohet ekzogjen dhe jo i lidhur me termin e gabimit. PBB-ja e kaluar përdoret gjithashtu si një instrument i brendshëm për të shmangur problemin e endogjenitetit.

Siç përmendet dhe më lart, rajoni i Ballkanit është karakterizuar nga ndarja e Federatës së Ish-Jugosllavisë, krijimi i shteteve të reja (Bosnje-Hercegovina, Kroacia, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia dhe Sllovenia), si dhe nga konfliktet e armatosura. Për këtë arsye, disa të dhëna mbi tregtinë dypalëshe nuk janë në dispozicion. Për shembull, të dhënat mbi eksportet e Bosnje-Hercegovinës drejt rajonit janë të disponueshme vetëm duke filluar nga viti 2002 e në vazhdim (ndërkohë që të dhënat mbi eksportet nga vendet rajonale drejt Bosnje-Hercegovinës janë të disponueshme duke filluar nga viti 2000). Gjithashtu, mungojnë të dhënat mbi flukset tregtare dypalëshe midis Bosnje-Hercegovinës dhe Serbisë e Malit të Zi për vitet 2000-2001. Nisur nga karakteristikat specifike të të dhënave që po vlerësohen, do të ishte më e përshtatshme të përdorej modeli i vlerësimit GMM jolinear. Ky i fundit nuk kërkon në mënyrë rigorozë specifikimin e instrumenteve të dhura (Harris etj., 2008). Kushti i nevojshëm për *t*'u përmbushur është që numri i kushteve të momentit duhet të jetë të paktën i barabartë ose më

i madh se numri i parametrave që po vlerësohen. Kushti do të ishte që varianca e u_{ijt} është një konstante (shiko shpjegimin në paragrafin e mësipërm) dhe që të gjithë elementët stokastikë të ekuacionit janë të pavarur (Harris etj., 2008).

Literatura mbi modelin e vlerësimit GMM sugjeron se ai duhet të përdorë sa më shumë variabla instrumentale që të jetë e mundur. Megjithatë, në rastin e një kampioni të kufizuar, kjo mund të sjellë problemin e kurtheve (Harris, Matzas, dhe Sevestre, 2008). Duke qenë se ky material përdor një kampion të kufizuar (11 vjet), variablat e tij instrumentale janë të vendosur në një dinamikë kohëvonesash (-1 deri në -3). Kjo arrihet duke përdorur variablat e mëposhtëm instrumentale: C(konstante), LogTregti(-1 deri në -3); LogPBB(-1 deri në -3) LogPBBPF(-1 deri në -3) dhe variabli cilësor i Gjuhës së Përbashkët. Duke përdorur tregtinë në të kaluarën dhe PBB-në në të kaluarën (-1 deri në -3 kohëvonesa) si variabla instrumentale, ne shmangim problemin e endogjenitetit. PBBPF-ja e vonuar (-1 deri në -3) përdoret gjithashtu si një variabël instrumentale për të identifikuar efektin e të ardhurave në të kaluarën mbi tregtinë. Ekuacioni përdor gjithashtu variablin cilësor të gjuhës si një variabël instrumentale. Literatura mbi modelet e gravitetit për tregtinë e konsideron variablin cilësor të gjuhës së përbashkët si një variabël të rëndësishëm në shpjegimin e tregtisë dypalëshe (shiko Pllaha, A. 2010). Megjithatë, vendet specifike të EJT-9 që flasin një gjuhë të përbashkët (Bosnje-Hercegovina, Kroacia dhe Serbia e Mali i Zi) janë përfshirë në konflikte të armatosura gjatë viteve 1990. Për rrjedhojë, përfshirja e këtij variabli cilësor në ekuacion prodhoi një koeficient (për variablin e gjuhës së përbashkët) me shenjë negative. Kështu, në mënyrë që një variabël i tillë i rëndësishëm të mos injorohet, ne e përdorim si një variabël instrumentale në ekuacionin e mëposhtëm GMM.

Duke përdorur metodën GMM, shmangen problemet e heteroskedasticitetit dhe të autokorrelacionit. Duke marrë në konsideratë argumentet e lartpërmendura, modeli dinamik i zhvilluar mund të shkruhet si më poshtë:

$$\log Tregtia_{ijt} = \alpha_0 + \alpha_1 \log Tregtia_{ijt-1} + \alpha_2 \log(PBB_{it} * PBB_{jt}) + \alpha_3 \log(Distanca_{ijt}) + \alpha_4(MTL_{ijt}) + \alpha_5(LidhjeKoloniale_{ijt}) + \alpha_6(Fqinjësia_{ijt}) + u_{ijt} \quad (3)$$

ku: $\log Tregtia_{it,t-1}$ përfaqëson tregtinë dypalëshe në të kaluarën, të përfshirë në ekuacion si një variabël shpjegues. Vini re që PBBPF nga ekuacioni (2) është hequr në ekuacionin e fundit (3), me qëllim shmangien e problemit të keqspecifikimit të ekuacionit.

Materiali gjithashtu diagnostikon rezultatet empirike në drejtim të qëndrueshmërisë, në mënyrë që të kontrollohet qëndrueshmëria e të dhënave dhe kufizimet e tejidentifikuara. Ky diagnostikim, karakteristikat e të dhënave dhe rezultatet empirike trajtohen në seksionin në vijim të këtij materiali.

4. REZULTATET EMPIRIKE

4.1 TË DHËNAT

Të dhënat e përdorura për aplikimin empirik të modelit dinamik të gravitetit (i ndërtuar nga modeli bazë i Frankel, Stein dhe Wei, 1997) është si vijon:

- Variabli i varur përfaqëson flukset aktuale tregtare dypalëshe ndërmjet vendit i dhe j në kohën t , të shprehura në formën e tyre të logaritmit natyror. Më specifikisht, $\log Tregtia_{ijt}$. Burimi: Baza e të dhënave UNCOMTRADE.
- Variablat shpjegues:
 - Produktet e Brendshme Bruto Reale të eksportuesit dhe të importuesit në formën e tyre të logaritmit natyror (përkatesisht, PBB_{it} dhe PBB_{jt}); Burimi: *World Bank World Tables* (Treguesit e Zhvillimit Botëror).
 - Distanca në kilometër ndërmjet qendrave ekonomike i dhe j , e shprehur në terma të logaritmit natyror. Më specifikisht, $\log(Distanca_{ij})$. Burimi: Baza e të dhënave të distancës Michelin (www.viamichelin.com).
 - MTL_{ijt} , variabli cilësor i Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë, në rast se ndërmjet dy vendeve ekziston një MTL aktive. Burimi: Komisioni Evropian <http://ec.europa.eu> dhe <http://www.stabilitypact.org> (Duhet përmendur se variablat e cilësuar për MTL-të dypalëshe që kanë hyrë në fuqi pas gjashtëmujorit të parë të çdo viti specifik shënohen si =1 në vitin e ardhshëm. Besohet se nevojitet të kalojë pak kohë nga hyrja në fuqi e marrëveshjeve të tregtisë së lirë që ato të kenë ndikim.)
 - LidhjeKoloniale $_{ijt}$, variabli cilësor i lidhjes koloniale nëse vendet i dhe j kanë qenë pjesë e të njëjtit territor gjatë 50 viteve të fundit. Burimi: Baza e të dhënave CEPPI: <http://www.cepii.fr>
 - Fqinjësia $_{ijt}$, variabli cilësor i fqinjësisë nëse vendet i dhe j ndajnë të njëjtin kufi. Burimi: Komisioni Evropian dhe baza e të dhënave CEPPI: <http://www.cepii.fr>

4.2 REZULTATET

Siç përmendet dhe më lart, ky material diskutimi synon të vlerësojë kontributin e MTL-ve në flukset tregtare në rajonin e Evropës Juglindore (EJL-9). Autorë të ndryshëm, të cilët më parë kanë përdorur modelet e gravitetit për tregtinë, kryesisht kanë përdorur modelin statik të vlerësimit të të dhënave në panel, më specifikisht metodën OLS. Siç theksohet dhe më lart në material, ekzistojnë disa arsye teorike ekonomike për të besuar se tregtia aktuale ndikohet nga flukset tregtare në të kaluarën dhe nga PBB-ja e kaluar. Për të mundësuar përfshirjen e këtyre dinamikave, në seksionin e tretë të këtij materiali u ndërtua një model dinamik GMM për të vlerësuar flukset tregtare (modeli (3)). Mjaft argumente ekonometrike dhe teorike (siç theksohet në seksionin e modelimit) sugjerojnë se modeli GMM është modeli i duhur për të mundësuar përfshirjen e dinamikave në modelin e gravitetit për tregtinë. Megjithatë, vlefshmëria e rezultateve të përfthuara nga modeli jolinear tërësisht i zhvilluar GMM (3) do të varet nga testet dhe diagnostikimet statistikore.

Siç shpjegohet dhe më lart, kushti thelbësor që vlerësuesi GMM të specifikohet në mënyrë korrekte është që në model duhet të jenë të paktën po aq instrumente sa dhe parametra (shiko Arellano dhe Bond, 1991; Harris etj. 2008). Nëse numri i instrumenteve është më i madh sesa numri i parametrave, atëherë vlera e funksionit të objektivit të optimizuar (*J-statistics*) do të jetë më e madhe se zero. Diagnostikimi më i rëndësishëm statistikor në vlerësimin GMM është testi Sargan i kufizimeve të tejdentifikuara. Për realizimin e vlerësimit GMM të këtyre të dhënave specifike në panel, ky material përdor *Eviews 6*. Në këtë të fundit, *J-statistic* është thjesht statistika Sargan. Këtu vlen të përmendet se *J-statistic* e raportuar nga një ekuacion në panel ndryshon nga ai i raportuar nga një ekuacion i zakonshëm me një faktor të barabartë me numrin e vëzhgimeve. Modeli GMM (3) në mënyrë të qartë e kalon testin Sargan të kufizimeve të tejdentifikuara duke përdorur formulën e mëposhtme: "vlera *p* shkallare = @chisq(*J-statistics value*, renditja e instrumentit – numri i koeficientëve të vlerësuar)". "vlera *p* shkallare" për modelin (3) = 0.399039098951. Kjo sugjeron se modeli zotëron instrumente të vlefshme dhe kështu, ai është specifikuar siç duhet.

Modeli gjithashtu e kalon testin Hausman (1978), i cili është një supozim i rëndësishëm në vlerësimin e efekteve rastësore, duke supozuar se efektet rastësore nuk janë të korreluara me variablat shpjegues (shiko Shtojcën 1).

Tani që modeli ka kaluar në mënyrë të suksesshme diagnostikimet e nevojshme të modelit GMM të vlerësimit në panel, materiali mund të vijojë me diskutimin e rezultateve të vlerësuara.

Modeli tërësisht i specifikuar (3) jo vetëm që kalon testin statistikor diagnostik, por ai gjithashtu zbulon disa rezultate interesante. Duhet nënvizuar se pothuajse të gjithë variablat e vlerësuar janë statistikisht të rëndësishëm dhe koeficientët e tyre kanë shenjë e pritur. Në përputhje me literaturën mbi modelin e gravitetit, variabli i PBB-së rezulton statistikisht i rëndësishëm (me nivel rëndësie 1%) dhe me një ndikim pozitiv mbi flukset tregtare dypalëshe me një konstante prej 0.226.

Përfundimi më interesant i rezultateve të gravitetit është që tregtia aktuale ndikohet nga tregtia në të kaluarën. Përfshirja e variablit të parë të varur në të kaluarën (1 tregti paraardhëse) rezultoi me një konstante të madhe pozitive të koeficientit (0.638) dhe mjaft i rëndësishëm (me nivel rëndësie 1%). Kështu, sugjerohet se vëllimet e tregtisë së vitit të kaluar do të kenë një ndikim pozitiv të rëndësishëm mbi tregtinë aktuale. Kjo provon supozimin teorik se tregtia aktuale ndikohet nga tregtia në të kaluarën për shkak të konceptit të “forcës së zakonit”, duke supozuar që konsumatorët mësohen me produkte specifike të cilat i kanë përdorur me kalimin e kohës (Bun dhe Klaassen, 2002; Harris etj. 2008).

Siç pritej, variabli i distancës ka një ndikim negativ mbi flukset tregtare. Ai është statistikisht i rëndësishëm me një nivel rëndësie prej 1% dhe negativisht i lidhur me flukset tregtare (-0.180).

Një nga objektivat kryesorë të këtij materiali është të shqyrtojë nëse MTL-të midis vendeve të EJK-9 kanë pasur një ndikim pozitiv mbi flukset tregtare. Vlerësimi GMM sugjeron se variabli i MTL-së është statistikisht i rëndësishëm (me një nivel rëndësie 1%). Për variablin e MTL-së, vlerësimi GMM prodhon një koeficient pozitiv

prej 0.365. Kështu, kjo sugjeron se heqja e taksës së kufirit ka kontribuar pozitivisht në flukset tregtare rajonale dhe në integrimin e tregtisë rajonale.

Variabli cilësor i pandryshueshëm në kohë i fqinjësisë është gjithashtu statistikisht i rëndësishëm me një nivel rëndësie 1% dhe ai ka një ndikim pozitiv mbi tregtinë dypalëshe (me një koeficient 0.310). Siç sugjerohet dhe nga literatura, vendet fqinje tregtojnë më shumë ndërmjet njëri-tjetrit, për shkak të lidhjeve tregtare të krijuara me kalimin e kohës.

Në përputhje me sugjerimet e literaturës, variabli cilësor i lidhjes koloniale ka një ndikim pozitiv mbi tregtinë dypalëshe. Ky variabël cilësor është statistikisht i rëndësishëm me një nivel rëndësie 1% dhe me një ndikim të rëndësishëm mbi tregtinë aktuale (0.483). Një gjë e tillë sugjeron se historia e përbashkët dhe ngjashmëritë kulturore kontribuojnë në rrjetet tregtare, të cilat vijojnë ende të funksionojnë dhe pas ndarjes së vendeve (federatave).

4.3 TREGTIA AKTUALE KUNDREJT TREGTISË POTENCIALE

Duke aplikuar rezultatet e koeficientit nga vlerësimi GMM në modelin e gravitetit (3), mund të përftohen vlerat e tregtisë dypalëshe potenciale ndërmjet vendeve i dhe j në një vit specifik t (Baldwin, 1994; Bussiere etj. 2005). Këto raporte të flukseve tregtare potenciale mund të krahasohen më pas me raportet e flukseve tregtare aktuale⁶. Rezultatet e modelit të gravitetit japin disa përfundime interesante. Për shembull, rezultatet sugjerojnë se flukset tregtare aktuale ndërmjet pothuajse të gjitha vendeve të EJL-9 janë nën nivelin e tyre potencial. Ky seksion trajton vlerësime mbi tregtinë aktuale kundrejt asaj potenciale për dy vende specifike të EJL-9 (Shqipëria dhe Bullgaria). Raportet për tregtinë potenciale sugjerojnë se flukset tregtare ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve të EJL-9 janë mjaft poshtë potencialit të tyre (shiko Shtojcën 2 në seksionin 7). Për shembull, flukset tregtare dypalëshe ndërmjet

⁶ Siç ilustron në Shtojcën 2, paraqitjet grafike janë subjekt i një kufizimi metodologjik për ekonominë e EJL-9.

Shqipërisë dhe pjesës tjetër të vendeve të EJT-9 në vitin 2010 ishin vetëm rreth 10% e potencialit të tyre (rreth 8% me Bosnje-Hercegovinë, 10% me Bullgarinë, 12% me Kroacinë, 7% me Rumaninë, 17% me Serbinë dhe Malin e Zi dhe 7% me Slloveninë). Ndërkohë që po në këtë vit, flukset tregtare dypalëshe me Turqinë ishin sa rreth 22% e potencialit. Në mënyrë të ngjashme me pjesën më të madhe të vendeve të EJT-9, flukset tregtare të Shqipërisë me vendet rajonale janë nën potencialin e tyre. Analizat sugjerojnë se vendet e EJT-9 tregtojnë nën potencialin e tyre dhe se flukset tregtare ndërmjet tyre mund të intensifikohen. Këto gjetje janë në linjë me gjetjet e Kucharčuková, Babecký dhe Raiser (2010), të cilët gjithashtu identifikojnë se vendet e EJT-së tregtojnë nën potencialin e tyre, jo vetëm ndërmjet tyre por dhe me pjesën tjetër të botës.

Në vitin 2010, në mënyrë të ngjashme me Shqipërinë, flukset tregtare aktuale të Bullgarisë me pjesën më të madhe të vendeve të EJT-9 ishin mjaft poshtë potencialit të tyre (rreth 5% me Bosnje-Hercegovinë, 12% me Kroacinë, 20% me Maqedoninë, 35% me Serbinë dhe Malin e Zi, 13% me Slloveninë dhe 10% me Shqipërinë). Në këtë mënyrë, sugjerohet ekzistenca e potencialit të tregtisë ndërmjet Bullgarisë dhe vendeve të lartpërmendura. Modeli i gravitetit prodhon disa rezultate interesante lidhur me raportet e flukseve tregtare ndërmjet Bullgarisë dhe pjesës tjetër të vendeve të EJT-9. Kështu, raporti i flukseve tregtare aktuale në vitin 2010 ndërmjet Bullgarisë dhe Rumanisë (rreth 90%), Bullgarisë dhe Turqisë (rreth 68%) ishte shumë më afër potencialit të tyre. Duket se Bullgaria dhe dy vendet e lartpërmendura kanë arritur të integrohen thellësisht dhe të realizojnë flukse tregtare pothuajse në potencialin e tyre. Këto gjetje janë gjithashtu në linjë me gjetjet e Pllaha, A. (2010): integrimi tregtar i Shqipërisë me Italinë dhe Greqinë ishte afër potencialit të tij, megjithatë, integrimi tregtar me vendet rajonale ishte shumë më poshtë potencialit.

4.4 ZBATUESHMËRIA NË VENDIMMARRJE

Qëllimi i këtij materiali ishte që të kontribuonte si në literaturën mbi rëndësinë e dinamikave në modelet e gravitetit për tregtinë, ashtu dhe në zbatueshmërinë praktike të politikëbërjes mbi

integrimin tregtar të vendeve të EJL-9. Në seksionin e mëparshëm u nënvizua rëndësia e tregtisë në të kaluarën, në shpjegimin e flukseve tregtare aktuale. Më poshtë renditen disa këshilla dhe sugjerime, të cilat mund të gjejnë zbatim në vendimmarrje, bazuar në gjetjet dhe rezultatet e modelit të gravitetit.

Gjetja empirike se flukset tregtare aktuale ndikohen nga tregtia në të kaluarën nuk kontribuon vetëm në literaturën mbi rëndësinë e dinamikave në shpjegimin e flukseve tregtare, por tregon edhe rëndësinë e marrëdhënieve tregtare ndërmjet vendeve të EJL-9. Vendimmarrësit duhet t'i mbështesin dhe nxisin këto marrëdhënie ekonomike, të cilat kontribuojnë në intensifikimin e tregtisë.

Materiali gjithashtu identifikon kontributin pozitiv të MTL-ve në flukset tregtare ndërmjet vendeve të EJL-9. Kjo gjetje sugjeron se përshtatjet e sinkronizuara të politikave në nxitjen e tregtisë dypalëshe kanë kontribuar pozitivisht në flukset tregtare ndërmjet këtyre vendeve. Intensifikimi i shpejtë i tregtisë ndërmjet vendeve të EJL-9 pas vitit 2002 mund t'i atribuohet MTL-ve dypalëshe. Me fjalë të tjera, marrëveshjet dypalëshe të tregtisë kanë kontribuar në krijimin e një zone të lirë tregtare rajonale.

Variabli i distancës (kostot e transportit) rezulton se ndikon negativisht mbi flukset tregtare rajonale. Megjithatë, shkurtimi i distancës fizike (ndërtimi i rrugëve, autostradave, porteve, hekurudhave, etj.) nuk është mënyra e vetme për të ulur kostot e transportit (ndonëse është mjaft e rëndësishme). Qeveritë e vendeve të EJL-9 mund të ulin kostot e transportit edhe përmes integrimit më të thellë dhe krijimit të kërkesave të ngjashme për dokumentacion, shmangies së kontrolleve të dyfishta/trefishta kufitare, krijimit të kërkesave të ngjashme për standardet në tregun rajonal, etj.

Gjithashtu, modeli sugjeron se lidhjet koloniale kanë pasur një ndikim të madh mbi flukset tregtare. Kjo nënvizon dhe një herë rëndësinë e lidhjeve tregtare historike për tregtinë aktuale. Ngjashmëritë kulturore dhe historia e përbashkët kanë një ndikim pozitiv mbi integrimin e tregtisë.

Materiali gjithashtu del në përfundimin se flukset tregtare aktuale ndërmjet vendeve të EJL-9 janë mjaft poshtë potencialit të tyre. Modeli i gravitetit sugjeron se flukset tregtare ndërmjet këtyre vendeve mund të intensifikohen më tej. Ndonëse MTL-të kanë kontribuar pozitivisht në flukset tregtare rajonale, rajoni ende përfaqëson një mundësi për integrim tregtar të mëtejshëm.

5. PËRFUNDIME

Për ta përmbledhur, evidencat e përgjithshme mbështesin rëndësinë e përfshirjes së dinamikave në modelet e gravitetit për tregtinë. Modeli GMM duket të jetë modeli i duhur ekonometrik që mundëson përfshirjen e këtyre dinamikave në model. Modeli prodhoi rezultate të qëndrueshme (në terma të diagnostikimit statistikor), duke nënvizuar se tregtia në të kaluarën kontribuon pozitivisht në flukset tregtare aktuale dhe të ardhshme. Në përputhje me literaturën mbi modelet e gravitetit për tregtinë, materiali sugjeron se tregtia ndikohet pozitivisht nga PBB-ja, MTL-të, Lidhjet Koloniale dhe nga Fajnjësia. Flukset tregtare rezultojnë se ndikohen negativisht nga distanca fizike ndërmjet vendeve. Gjetjet sugjerojnë se MTL-të kanë kontribuar pozitivisht në integrimin tregtar rajonal, edhe pse materiali del në përfundimin se pjesa më e madhe e vendeve të EJL-9 tregtojnë nën potencialin e tyre.

Krahas përdorimit të distancës në kilometra, puna kërkimore në të ardhmen e përqendruar në tregtinë rajonale, mund të kontribuojë në këtë çështje përmes hulumtimit të mëtejshëm mbi mënyra të tjera të matjes së kostove të transportit. Në modelin e gravitetit mund të përfshihen variabla të tjerë shpjegues (për shembull, kursi i këmbimit në të dy vendet). Gjithashtu, puna kërkimore në të ardhmen mund të kontribuojë në këtë çështje duke u përqendruar më tepër në karakteristikat e sektorit të tregtisë.

LITERATURA

Aitken, N.D. (1973), *The Effect of EEC and EFTA on European Trade: A Temporal Cross Section. Analysis*, *American Economic Review*, 63.

Alessandri, P. (2000) *European and Euro-Mediterranean Agreements: Some Simulation Analysis on the Effects of the EU Trade Policy*, Centre for Research on Innovation and Internationalisation (CESPRI) Working Paper, No 110, Università Bocconi, Milan, June.

Augier, P. and Gasiorek, M., (2001), *The Welfare Implications of Trade Liberalization between the Southern Mediterranean and the EU*, School of European Studies, University of Sussex, November.

Bayoumi, T. and Eichengreen, B. (1997), *Is Regionalism Simply a Diversion? Evidence From the Evolution of the EC and EFTA*, in Ito, T. and A. O. Krueger eds., *Regionalism versus Multilateral Trade Arrangements*, The University of Chicago Press, Chicago.

Bun and Klaassen (2002), *The Importance of Dynamics on Panel Gravity Models of Trade*.

Bussiere et al., (2005) *Trade Integration of Central and Eastern European Countries: Lessons from a Gravity Model*.

Bussolo, M., and Niimi, Y. (2005), *Do the Poor benefit from Regional Trade Pacts? An Illustration from the Central America Free Trade Agreement in Nicaragua*, Paper prepared for the 8th Annual Conference on Global Economic Analysis, June 9 - 11, Lübeck.

Cheng, I-H. and H. J. Wall (2005). *Controlling for heterogeneity in gravity models of trade and integration*. *Federal Reserve Bank of St. Louis Review*, 87, 1, 49-63.

Council of The European Union (2006); *Stabilization and Association Agreement between the European Communities and their Member States, of the one part, and the Republic of Albania, of the other part*: Brussels.

Efendic et al. (2009), *Institutions and economic performance: System GMM modelling of institutional effects in transitin*, Staffordshire University Business School, Leek Road, Stoke-on-Trent, College Road, ST4 2DF, UK.

Frankel, J., Stein E. and Wei S., (1997), *Regional Trading Blocs in the World Economy*, Institute of International Economics, Washington D.C., October.

Harris et al (2008), *Production profile compatibility in a dynamic gravity model of trade*, March.

Hoekman, B. and Konan, E. (1998), *Deep Integration, Non-discrimination and European Free Trade*, Paper presented at Conference Regionalism in Europe: Geometries and Strategies after 2000, Bonn, November 6-8.

Jarvis, Ch. (2000), *The Rise and Fall of Albania's Pyramid Schemes* (IMF, 2000).

Kaminski, B. and de la Rocha, M. (2003), *Stabilization and Association Process in the Balkans: Integration Options and their Assessment*, Washington.

Kucharčuková, O. Babecký, J. and Raiser, M. (2010) *A Gravity Approach to Modelling International Trade in South-Eastern Europe and the Commonwealth of Independent States: The Role of Geography, Policy and Institutions*.

Krugman, P. (1979), *Increasing Returns, Monopolistic Competition and International*

Trade, *Journal of International Economics*.

Kovac, Oskar (1998), *Trade Flows among Balkan Countries and Opportunities with SECI*, paper prepared for the American Association for the Advancement of Slavic Studies (AAASS) Conference in Boca Raton, Florida.

Lawrence, R., (1997a), *Preferential Trade Agreements: the Traditional and the Old*, in A. Galal and B. Hoekman eds., *Regional Partners in Global Markets: Limits and Possibilities of the Euro-Med Agreements*, Center for Economic Policy Research, London.

Linder, S. (1961), *An Essay on Trade and Transformation.*” Uppsala: Almqvist and Wiksells.

Linnemann, H. (1966). *"An Econometric Study of International Trade Flows, Amsterdam: North Holland.*

Lipsey, R.G. (1957), *The Theory of Customs Unions: Trade Diversion and Welfare, Economica, 24, pp. 40-46.*

Maskus, K., and Eby Konnan, D. (1997), *Trade Liberalization in Egypt, Review of Development Economics, 1(3).*

Meade, D. (1955), *The Theory of Customs Unions, North-Holland, Amsterdam.*

NEXUS (2009), *DEVINPRO Fact Sheet Albania, Tirana 2009.*

Pllaha, A. (2010), *Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit BE – Shqipëri. Modeli i gravitetit për tregtinë: Rasti i Shqipërisë”, Banka e Shqipërisë, Tiranë, 18-19 nëntor 2010.*

Smith, A., and Venables, A. (1988), *Completing the Internal Market in the European Community: Some Industry Simulations, European Economic Review, 32 (7).*

Soloaga, I. and Winters, L.A. (2001), *Regionalism in the Nineties: What Effect on Trade?, North American Journal of Economics and Finance, Vol. 121.*

Stability Pact for South Eastern Europe (2006), Free Trade Agreements in SEE, Sarajevo.

Velde, D.W. te, Page, S. and Morrissey, O. (2004), *Regional Integration and Poverty: Mapping the Linkages, Report for an EC-PREP Project on Regional Integration and Poverty, Overseas Development Institute, London.*

Vika, (2006), *Matja e funksioneve të importit dhe eksportit në Shqipëri, Banka e Shqipërisë, dhjetor 2006.*

Viner, J. (1950), *The Customs Union Issue, Carnegie Endowment for International Peace, New York.*

World Bank (2000), *The Road to Stability and Prosperity in South Eastern Europe: A Regional Strategy Paper, Washington, March.*

Zahariadis, Y. (2007), *The Effects of the Albania-EU Stabilization and Association*

SHTOJCA


1. REZULTATET GMM TË MODELIT DINAMIK TË GRAVITETIT 3

Rezultatet e vlerësimit			
	Modeli bazë(1)	Modeli(1) + Variablat cilësorë	Modeli
Din_GMM(3)			
Tregtia _{ij, t-1}	-	-	0.638***
PBB _{ij}	0.540***	0.677***	0.226***
PBBPF _{ij}	0.519***	0.059	-
Distanca _{ij}	-1.707***	-0.277***	-0.180***
Variabli cilësor_MTL	-	0.770***	0.365***
Variabli cilësor_Fqinjësia	-	1.322***	0.310***
Variabli cilësor_Lidhje Koloniale	-	1.698***	0.483***
R ²	0.62	0.78	I panjohur për GMM
Testi Sargan (vlera p shkallare)			Po (0.399)
Testi Hausman			Po (0.237)

*** Nivel rëndësie 1%; **Nivel rëndësie 5%; *Nivel rëndësie 10%.


2. RAPORTET: FLUKSET TREGTARE AKTUALE KUNDREJT ATYRE POTENCIALE NDËRMJET VENDEVE TË EJL-9

Shtojcë 2a) Raportet: Flukset tregtare aktuale kundrejt atyre potenciale midis Shqipërisë dhe vendeve të EJL-9.



Burimi: Përlogaritjet e autorit duke përdorur vlerësimet e modelit të gravitetit.
Shënim: Shkalla midis grafikëve mund të ndryshojë për të mundësuar lexueshmërinë në përputhje me ndryshimet në flukset tregtare midis vendeve.

Shtojcë 2 b) Raportet: Flukset tregtare aktuale kundrejt atyre potenciale midis Bullgarisë dhe vendeve të EJT-9.



Burimi: Përlllogaritjet e autorit duke përdorur vlerësimet e modelit të gravitetit.

Shënim: Shkalla midis grafikëve mund të ndryshojë për të mundësuar lexueshmërinë në përputhje me ndryshimet në flukset tregtare midis vendeve.

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Alban Pllaha

Marrëveshjet e tregtisë së lirë dhe Integrimi
tregtar midis vendeve të Evropës Juglindore:

Vlerësime të modelit të gravitetit - /

/ Pllaha Alban - Tiranë:

Banka e Shqipërisë, 2012

-36 f; 15.3 x 23 cm.

Bibliogr.

ISBN: 978-99956-42-67-0.

Këtë publikim mund ta gjeni edhe në formë elektronike në adresën:

www.bankofalbania.org

*Në qoftë se dëshironi të keni kopje të
shkrvara të tij mund t'i kërkonit në adresën:*

Banka e Shqipërisë

Sheshi "Avni Rustemi", Nr. 24, Tiranë, Shqipëri

Tel.: + 355 4 2419301/2/3; + 355 4 2419409/10/11

Faks: + 355 4 2419408

ose duke dërguar një e-mail në adresën:

public@bankofalbania.org

Tirazhi: 500 kopje